

VENDIM
Nr.312, datë 12.3.2008

**PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË SHTETËRORE TË TRUALLIT DHE MJEDISEVE TË
NDËRMARRJES ELEKTROTEKNIKE, TIRANË, NGA PRONË SHTETËRORE NË PRONË
PRIVATE, PËR SHOQËRINË “ERJONI” SHPK, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 757-760 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 3, shkronja “b”, e 8 paragrafi i parë të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, dhe të neneve 4, 5, 10, 11, 12 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tjetërsimin e pronësisë shtetërore të truallit dhe të ndërtesës 2-katëshe, me tulla silikate, të ndërmarrjes elektroteknike, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 2209 m², sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Erjoni” sh.p.k. Tiranë.

2. Pagimi i çmimit nga shoqëria “Erjoni” sh.p.k. Tiranë, do të bëhet në natyrë, me sipërfaqe të lirë truall, që ka në pronësi kjo shoqëri, bazuar në krahasimin e vlerave të objekteve, të vlerësuara në shkëmbim, dhe në para, në shumën 14 230 560 (katërmbëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

3. Pronësia e ndërtesës dykatëshe, së bashku me truallin nën to, të kalojnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit te shoqëria “Erjoni” sh.p.k., përmes një kontrate tjetërsimi mbi pasuritë e paluajtshme, nënshkruar nga të dyja palët, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë dhe Kalibrimit për ta nënshkruar kontratën e shkëmbimit, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha